
VENDIM

Nr. 37 Datë 27.04.2010

PËR

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “400 KV” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, gërma “a, neneve 9 dhe 13 pika 1 gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pikat 1 gërma ”g”, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008,, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të dates 27.04.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “400 kv” sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për liçensim në aktivitetin e Tregëtimit të Energjise Elektrike,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “400 kv” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gërmat ”a”, ”a” dhe ”c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Autoriteti i Konkurrencës me vendimin nr. 144, datë 23.03.2010, ka vendosur ti rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë të pajisë me liçensë për tregëtimin e energjisë elektrike shoqërinë ”400 KV” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Licensimin e shoqërisë “400 KV” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike për një afat 5 vjeçar.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJE
Bordi i Komisionereve



-
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta” Nr.10
963
Tirane
69 590
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

www.ere.gov.al